



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:186679
Datë: 14.02.2025
Numri i dokumentit: 06853325

PAKR.nr.691/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Hashim Çollaku, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Jeta Asllani, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.K i akuzuar për shkak të veprës penale Dhunimi nga neni 227 par.4, nën par.4.1 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe veprës penale në bashkëkryerje Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, nën par.1.3 dhe 1.4 të KPRK-së, i akuzuari A.S për shkak të veprës penale Ndhimë në kryerjen e dhunimit nga neni 227 par.4, nënpar.4.1 lidhur me par.1 dhe nenin 33 të KPRK-së dhe veprës penale në bashkëkryerje Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, nën par.1.3 dhe 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ankesës së përfaqësuesit të dëmtuarve M.O1 dhe V.O, Av. G.R, ankesës së mbrojtësit të akuzuarit D.K, Av. S.M dhe ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit A.S, Av. A.Sh, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, 2021:186679, të datës 26.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ankesa e përfaqësuesit të të dëmtuarve M.O1 dhe V.O, Av. G.R, ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit D.K, Av. S.M dhe

ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit A.S, Av. A.Sh, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, 2021:186679, i datës 26.09.2024, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin me numër të lëndës 2021:186679, të datës 26.09.2024, të akuzuarin D.K e ka shpallur fajtor për veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së dhe të akuzuarin A.S për veprën penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, nënpar.1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

Të akuzuarin D.K për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.4, të KPRK-së, e ka gjykuar me dënim me burgim të përjetshëm, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 24.08.2021, e tutje.

Të akuzuarin A.S, për veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.08.2021, e tutje por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar në aktgjykim.

Të dëmtuarit: V.O dhe M.O1, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Të akuzuarit janë obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale secili të paguajë shumën nga 400€, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajnë secili shumën nga 50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I akuzuari D.K është liruar nga akuza për shkak të veprës penale Dhunimi nga neni 227 par 4 nën par 4.1, lidhur me par. 1 të KPRK-së.

I akuzuari A.S është liruar nga akuza për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e Dhunimit nga neni 227 par 4 nën par 4.1, lidhur me par 1 dhe nenin 33 të KPRK-së.

Meqë me asnjë prove të vetme nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer këto vepra penale.

Shpenzimet e procedurës penale për këtë pjesë të aktgjykimit bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë:

Prokuroria Themelore në Ferizaj për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal sa i përket të akuzuarit A.S. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të aprovojë ankesën ndërsa aktgjykimin e ankimuar të anulojë dhe çështjen të kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara M.O1 dhe V.O, Av. G.R, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal për të akuzuarin A.S. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të akuzuarit A.S t'i shqiptojë një dënim më të lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.K, Av. S.M, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të aprovojë ankesën, të anulojë aktgjykimin dhe çështjen të kthejë në rigjykim, të aprovojë propozimin e mbrojtësit për përjashtimin e trupit gjykues dhe Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe të caktohet ndonjëra nga Gjykatat Themelore- Departamenti i Krimeve të Rënda që të gjykojë këtë çështje penale, ose të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, të bëjë ricilësimin e veprës penale nga vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, nënpar.1.4, në veprën penale të vrasjes nga neni 172 lidhur me nenin 19 të KPRK-së dhe t'i shqiptojë dënim më të ulët.

Mbrojtësja e të akuzuarit A.S, Av. A.Sh për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të aprovojë ankesën, të ndryshojë aktgjykimin dhe të akuzuarin A.S ta lirojë nga akuza apo çështjen ta kthejë në rigjykim.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.626/2024, të datës 25.11.2024 ka propozuar që të aprovohen si të bazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe ankesa e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara M.O1 dhe V.O, Av. G.R, aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen

të kthejë në rigjykim dhe rivendosje, ose aktgjykimin të ndryshojë dhe të akuzuarve tu shqiptojë dënime më të larta. Ndërsa të refuzohen si të pabazuara

Në kuptim të nenit 390 të KPPRK-së Kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për datë 14.01.2025 dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit prezantuan i dëmtuari M.O1, përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara M.O1 dhe V.O, Av. G.R, i akuzuari D.K, mbrojtësi i të akuzuarit D.K, Av. S.M, i akuzuari A.S, mbrojtësit e të akuzuarit A.S, Av. A.Sh dhe Av. A.I, ndërsa Prokurori i Apelit dhe e dëmtuara V.O, ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë.

Përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara M.O1 dhe V.O, Av. G.R ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ankesës dhe ka propozuar që marr parasysh veprën e rëndë penale të kryer ndaj të akuzuarit A.S të rritet dënimi me burgim.

I dëmtuari M.O1 ka deklaruar se pajtohet me deklarinimin e përfaqësuesit.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.K, Av. S.M ka deklaruar se kundërshton propozimin e Prokurorisë së Apelit për të refuzuar ankesën e mbrojtësit. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale, pasi që nuk ka marr parasysh konstatimet e Gjykatës së Apelit, ashtu që paraqet shkelje të nenit 1, par.2 sepse nuk ka zbatuar dispozitat lidhur me konstatimet e Gjykatës së Apelit. Gjykatës së Apelit i ka propozuar përjashtimin e Gjykatës së shkallës së parë për shkak të presionit publik, të anulohet aktgjykimi dhe çështja të kthehet në rigjykim.

I akuzuari D.K ka deklaruar që e mbështet deklarinimin e mbrojtësit dhe se i vie keq për rastin që ka ndodhur.

Mbrojtësja e të akuzuarit A.S, Av. A.Sh ka deklaruar se mbetet pranë pretendimeve në ankesë. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim, ose i akuzuari A.S të lirohet nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.S, Av. A.I ka deklaruar se pajtohet me deklarinimin e Av. A.Sh dhe i bashkangjitet propozimit të të njëjtës në ankesë.

I akuzuari A.S ka deklaruar se pajtohet me deklarinimin e mbrojtësve.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPRK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore në ankesë gjeti se:

Ankesat e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, përfaqësuesit të dëmtuarve M.O1 dhe V.O, Av. G.R, mbrojtësit të akuzuarit D.K, Av. S.M dhe mbrojtëses së të akuzuarit A.S, Av. A.Sh, janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore të Prokurorit të shtetit

Prokurori i shtetit në ankesë pretendon se Gjykata e shkallës së parë me rastin e përpilimit të aktgjykimin ka bërë shkelje të nenit 385 par.2, nën par 2.7 të KPP-së pasi aktgjykimi nuk është hartuar në pajtim me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPP-së, pasi gjykata në arsyetimin e pjesës liruese të aktgjykimin nuk i ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i ka konsideruar të pa vërtetuar gjegjësisht përse të pandehurit D.K dhe A.S i ka liruar nga vepra penale Dhunimi gjegjësisht ndihma në kryerjen e veprës penale Dhunimi.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të provave ka bërë shkelje të nenit 386 par 1 të KPP-së, për shkak se gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka ardhur në përfundim se veprimet e të pandehurit D.K nuk janë manifestuar elementet e figurës së veprës penale Dhunimi nga neni 227 par.4, nën par 4.1, lidhur me par.1 të KPRK-së, kurse për të pandehurin A.S nuk janë manifestuar elementet e figurës së veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale dhunimi nga neni 227 par.4, nën par 4.1 lidhur me par.1 dhe nenin 33 të KPRKsë.

Sipas prokurorit, pretendimi i gjykatës se me qenë se nuk vërehet në video incizime se ka pasur marrëdhënie seksuale në mes të pandehurit D.K dhe të ndjerës M.O nuk është vërtetuar vepra penale e dhunimit nuk qëndron, pasi nga video incizimet të cilave i referohet gjykata në këtë pjesë të aktgjykimin vërehet se në ora 09:53, i pandehuri D.K dhe e ndjera M.O, kthehen në banesë ku vërehet se e ndjera nuk ka kontroll të plotë, i merren mendtë, 10:02, i pandehuri e dërgon në banjë të ndjerën M.O, pastaj del në ora 10:14. ku vërehet se e njëjta reziston, mirëpo është kapur me duar dhe shtyhet me forcë drejt sallonit, në ora 10:48, e dërgon me forcë në

banjë, ku e ndjera është e zhveshur, ndërsa i pandehuri është veshur ku qëndrojnë deri në ora 11:09, kur dalin i pandehuri është zhveshur, dhe te ndjerën me dhunë e nxjerr nga banjë dhe e dërgon në dhomën e gjumit, po ashtu nga video incizimet e mëtejme vërehet se i pandehuri në dy raste duke e bartur për shkak se nuk është në gjendje të lëviz vet e dërgon në banjë të ndjerën e cila është lakuriq, po ashtu vërehet se e njëjta ka lëndime ne kofshë. Po të qëndron ky pretendim atëherë gjykata duke u bazuar në po këtë standard është dashur që të merr aktgjykim lirues edhe sa i përket veprës penale të vrasjes, pasi edhe vrasja nuk vërehet në video incizim.

Po ashtu edhe substanca- barna Tradamol, që gjatë ekzaminimit është gjetur në trupin e te ndjerës e cila si efekt të zakonshëm anësor ka marrje mendsh, çrregullime të koordinimit, çrregullime te përqendrimit, është fakt që tregon se e njëjta nuk ka qenë në gjendje të këtë kontroll mbi veten e saj.

Sipas prokurorit, nga provat e konstatuara, është vërtetuar se në mes pandehurit dhe të ndjerës ka pasur marrëdhënie seksuale kjo vërtetohet nga fakti se gjatë kryerjes së autopsisë së trupit të pa jetë janë marr dy strisho vaginale nga viktima M.O, të cilat janë marr në IML nga patologu Dr.N.H, të cilat me zinxhir të ruajtjes janë pranuar nga krim teknika, dhe të njëjtat së bashku me dëshmitë tjera janë dërguar në AKF për ekzaminim dhe krahasim me strishot e marra nga të pandehurit D.K dhe A.S, nga strishot vaginale të marra nga e ndjera dhe të pandehurit ka rezultuar se të njëjtat i përkasin të ndjerës dhe të pandehurit D.K. Po ashtu nga provat e administruara e sidomos videoincizimet e marra brenda nga korridori i banesës e ku shihet se e ndjera në fillim edhe pse nuk është plotësisht e orientuar reziston dhe qartë dhe ne mënyrë serioze, se nuk është e pëlqimit për të kryer akt seksual ose për ta vazhduar atë, mirëpo i pandehuri me forcë e dërgon në banjë derisa e njëjta është lakuriq, e po ashtu me forcë e kthen në dhomë, gjithashtu ndërkohë e ndjera nuk është e aftë për të dhënë pëlqim për aktivitete seksuale për shkak së aftësisë së zvogëluar mendore dhe fizike, zvogëlim që ka ardhur si pasojë e dhunës fizike dhe psikike që është përdorur nga i pandehuri, fakt ky që vërtetohet nga video incizimet ku i pandehuri shihet ne dy raste duke e bartur për shkak se nuk është ne gjendje të lëviz vet e dërgon ne banjë të ndjerën e cila është lakuriq, po ashtu vërehet se e njëjta ka lëndime ne kofshë.

Gjithashtu sipas prokurorit fakti se i pandehuri A.S, ka ndihmuar të pandehurin D.K, në kryerjen e veprës penale dhunimi, gjegjësisht duke krijuar kushte për vazhdimin e kryerjes së veprës

penale të dhunimit, kjo bazuar ne faktin se i njëjti posa hynë në banesën e të pandehurit D.K menjëherë hynë në dhomë, ku gjendej tani e ndjera M.O, e cila aty është lakuriq dhe i vërehen dëmtimet trupore, aty i njëjti hynë dhe del disa herë dhe gjatë gjithë kohës bisedojnë me D...n, po ashtu vetë prania e të pandehurit A.S, në dhomë ku ka qenë e ndjera duke u dhunuar është formë e ndihmës, pasi në njërën anë krijon siguri te kryesi e në anën tjetër pasiguri tek viktimja, me qenë se e njëjta, nuk ka guxuar për të bërë rezistencë, e po ashtu fakti se banesa e të pandehurit A.S, nga banesa ku është kryer vepra penale është rreth 600 metra, gjegjësisht më pak se 10 minuta këmbë dhe qëndrimi i tij gjatë gjithë natës ne banesën e të pandehurit, tregon qëllimin e tij për t'i ndihmuar të pandehurit D.K, në kryerjen e veprës penale, gjithashtu fakti se të njëjtit me qëllim të fshihen provat e veprës penale nga ia jap telefonin për te kontaktuar me kompaninë "S...", e cila menaxhon video incizimet nga kamerat e vendosura në banesën në G..., fakt ky që vërtetohet edhe nga ditari i punës i kompanisë në fjalë si dhe vet mbrojtja e të pandehurit, po ashtu herë pas here, përmes vrimës së derës se hyrjes në banesën në fjalë shikon nëse ndokush, është duke u interesuar se çka është duke ndodh në banesë, del nga banesa, shkon blen gjëra ushqimore për të pandehurin dhe për vete gjatë natës kur edhe nga i pandehuri D.K kryhet dhunimi. Provat kanë vërtetuar se ka pasur një shkopë të mes të kohës kur është kryer dhunimi dhe kohës kur është kryer edhe vrasja pasi nga video incizimet është vërtetuar fakti se vrasja ka ndodhur në intervale kohore nga ora 10:56 deri ne orën 14:43, kur i pandehuri i parë merr një shkop, e së bashku me të pandehurin e dytë hyjnë në dhomë dhe e godasin në pjesë të ndryshme të trupit, me ç'rast të njëjtës i shkaktojnë, dhimbje të mëdha fizike dhe psikike, ku nga goditjet pëson politrauma-lëndime te shumëfishta, ku vdekja shkaktohet drejtpërdrejtë nga asfiksia mekanike, si dhe shoku hemorragjik dhe traumatik, të cilat janë pasojë e gjakderdhjes së jashtme dhe gjakderdhjes së brendshme, nga thyerje e ashtit te nofullë së poshtme, thyerje e brinjëve, klavikulës së majtë, unazave të qafës, gjakderdhjes epidurale dhe subdurale në pjesën e pasme të trurit te madh dhe në trurin e vogël, këputje parciale të palcës së kurrit në qafë, të njëjtën e dërgojnë në Spitalin në F... dhe largohen nga aty. Të gjitha këto prova tregojnë se të pandehurit kanë kryer dy veprat penale.

Po ashtu, gjykata gabimisht e ka bërë rikualifikimin juridik të veprës penale në Vrasje të rëndë nga neni 173 par.1, nën par 1.4 të KPRK-së, gjegjësisht ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par 1, nën par 1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, pasi në dispozitiv të aktgjykimit gjykata e ka cekur se i pandehuri D.K dhe e ndjera M.O kanë qene duke

bashkëjetuar dhe rrjedhimisht është dashur të cekët edhe neni 173 par.1 nën par 1.3 të KPRKsë, i cili i referohet privimit nga jeta të anëtarit të familjes.

Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të palëve të dëmtuara M.O1 dhe V.O, Av. G.R

Sipas përfaqësuesit të palëve të dëmtuara ndryshimi dhe përkufizimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari A.S nuk mund të cilësohet si bashkëkryerës, nuk përputhet me provat që janë administruar dhe po ashtu me videoxhirimet që janë shikuar dhe analizuar në seancat gjyqësore. Ndiham sipas nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës përkufizohet kur një i pandehur apo akuzuar vetëm ndihmon por nuk kontribuon që ajo veprë të kryhet. Ndërsa i akuzuari i dytë ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë sepse i akuzuari A.S ka shprehur energji të madhe kriminale që të kryhet vepra penale e vrasjes së tashmë të ndjerës M.O. Sipas procesverbalit të datës 01.06.2023 tek prezantimi i provave shikimi i CD-ve, videoinqizimeve nga banesa e të pandehurit D.K, videoxhirimi i datës 20 dhe 21 gusht të vitit 2021, përshkruhet saktë sesa herë i akuzuari A.S hyn dhe del nga dhoma ku gjindet e ndjera e cila edhe ashtu paraprakisht kishte vështirësi në ecje dhe ishte komplet e zhveshur, e më pastaj në trupin e saj shihen shumë hematoma dhe shenja maviosje. Ndërsa në këtë procesverbal citohet se i akuzuari i dytë A.S paraprakisht disa herë ka hyrë dhe ka dalur aty ku është e zhveshur e ndjera. Sipas procesverbalit të datës 02.06.2023 janë përshkruar videoxhirimet në mënyrë të detajuar deri në vrasjen e të ndjerës. Në këtë përshkrim është cituar disa herë ku tashmë i dënuari A.S ka hyrë në dhomën ku gjindet e ndjera dhe atë e ka zhveshur, ka hyrë në dhomën ku gjindet e ndjera M.O dhe gjatë kohës kur D.K nuk ka qenë në banesë dhe A.S ka ndejtur brenda në dhomë dikund 1 minut. Disa herë ka përcjellë situatën ndërmjet vrimës së derës mos po vie dikush. Vetëm nga administrimi i Videoxhirimeve të cilat janë marrë nga banesa e të dënuarit D.K shihet qartë se A.S ka qenë bashkëkryerës i veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par 1 nën par 1.4.

Sipas përfaqësuesit, Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar thekson se i akuzuari ka qëndruar gjatë gjithë kohës sa është ushtruar dhunë ndaj të ndjerës nga ana e të akuzuarit D... dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtimin të evitimit të dhunës, por me vetëdije ka krijuar kushte. Tek i akuzuari i dytë janë shprehur haptas elementet objektive dhe subjektive. Tek lidhja objektive është se: ka kontribuar në kryerjen e veprës penale, ka ndërmarrë veprime, kontributi dhe veprimet lidhen me njëra tjetrën sepse vet Gjykata e ka përshkruar se të akuzuarit të dytë ja ka eliminuar pengesat për kryerjen e vrasjes së rëndë në mënyrë mizore dhe

për shkak të këtyre veprimeve ka qene rezultati kaq mizor. Dhe lidhja subjektive: kanë qene plotësisht të vetëdijshëm për kryerjen e kësaj vepre penale kane qenë edhe të njohur personalisht mes vete të dy të akuzuarit dhe ka ditur për pasojën si do të jetë në fund për shkakun se viktimja ka pasur shumë thyerje dhe lëndime në trup dhe është pamundur që ato të jenë shkaktuar brenda një kohe të shkurtër, kur vet në procesverbalin e datës 01 dhe 02 Qershor 2023 është evidentuar që e ndjera edhe me datën 19 dhe 20.08.2021 e ka pasur gjendjen e keqe dhe aty ka qene A.S.

Sipas përfaqësuesit vendimi për sanksionin penal për të akuzuarin e dytë në vetëm 15 vite burgim është i ulët duke pasur parasysh përshkrimin mizor të vrasjes. Në rast se gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar burgim të përjetshëm për të akuzuarin e parë për shkak të vrasjes së rëndë në mënyrë mizore konsideroj se për të akuzuarin e dytë për veprën penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë sipas nenit 173 par.1, nën par.4 është dashur të shqiptohet dënimi prej 25 vite burgim, sepse vrasja është bërë në mënyrë shumë brutale, mizore, në mënyrë të ngadalshme pa kurrfarë konsiderate apo brengje lidhur me shkaktimin e kësaj gjendjeje, ku raporti i autopsisë është provë që tregojnë viktimja se ka pasur gjymtim dhe/apo vuajtje përtej asaj që është e nevojshme për të shkaktuar vdekjen.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit D.K

Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtja konsideron se gjykata e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar çështjet kontestuese të Gjykatës së Apelit, pavarësisht vërejtjeve dhe udhëzimeve që janë dhënë në aktvendimin PARK.nr.677/23, të datës 11.01.2024. Gjykata e Apelit shprehimisht ka kërkuar që çështja e mizorisë të vërtetohet nga ekspertë të mjekësisë ligjore përmes ekspertizës, mirëpo gjykata e shkallës së parë nuk ka kërkuar të vërtetohet se a ka ekzistuar apo nuk ka ekzistuar mizoria në këtë çështje penale përmes nxjerrjes së ekspertizës nga ekspert e IML por vetëm ka ftuar ekspertin e mjekësisë ligjore në seancën e shqyrtimit gjyqësor për të sqaruar raportin e autopsisë duke anashkaluar zbatimin e kërkesave të Gjykatës së Apelit. Gjatë dëgjimit të ekspertit në seancën e shqyrtimit gjyqësor në asnjë rast eksperti nuk ka theksuar se vepra penale është kryer në mënyrë mizore madje ka deklaruar se nuk ka mundur ta përcaktojë në raportin e autopsisë ndërkaq sa ju përket shkallës së dhimbjeve të cilat gjykata i rendit si dhimbje në bazë të intensitetit të lartë apo shumë të lartë (njësojë si në raportet- ekspertizat në ndeshje të komunikacionit) nuk hynë në përshkrimin e dispozitës së nenit

173 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, që ka të bëjë me vrasjen në mënyrë mizore. Trupi gjykues duke ju shmangur deklaramit të ekspertit ka bërë shkelje esenciale nga 384 par.2 lidhur me nenin 5 të KPPRK-së dhe ka dështuar që të sigurojë gjykim të drejtë dhe të paanshëm duke mos siguruar konstatimin e saktë shkencor se a ka ekzistuar në rastin konkret kryerja e veprës penale të vrasjes mizore e me të cilat veprime të gjykatës i akuzuari është privuar nga e drejta për shterjen e të gjitha provave për vërtetimin e saktë të fakteve.

Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar nenin 7 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, për shkak se ka qenë e detyruar që ti vërtetojë të gjitha faktet e rëndësishme për të marr një vendim të drejtë siç është pretendimi i përdorimit të një shkopi të zi, marrja e mostrave të ADN-së nga shkopi për të vërtetuar se a është përdorur ky shkop për ta goditur viktimën.

Nuk është vërtetuar nga ekspertet mjeko ligjor se a ekziston mizoria nga i akuzuari D.K, nuk janë vërtetuar faktet se a janë shkaktuar lëndimet nga rrëzimi në tokë e viktimës gjatë bartjes se saj nga e të akuzuarit, nuk janë marrë Video incizimet nga kamerat e lokaleve aftër Spitalit në F... e në mënyrë të veçantë video incizimet nga barnatorja me emrin Z... ku dy të akuzuarit kanë deklaruar se D... është rrëzuar se bashku me të ndjerën para barnatores Z..., nuk janë marrë video incizimet nga objekti banesor ku ndodhet banesa e D..., nuk është ftuar asnjë dëshmitar - fqinje në banesën e D.K, nuk janë ftuar dëshmitar asnjë nga punëtorët e barnatores Z... apo nga lokalet afër spitalit të F... që kanë punuar në atë ndërrim, të gjitha këto lëshime janë bërë në dëm të akuzuarit, janë bërë nga ana e Prokurorisë gjatë hetimeve dhe nga ana e gjykatës së shkallës së parë gjatë shqyrtimit edhe përkundër faktit se Apeli ka udhëzuar që të dëgjohen të paktën fqinjët e D.K.

Gjykata e shkallës së parë përkundër faktit që Gjykata e Apelit të Kosovës e ka konsideruar deklaratën e të akuzuarit të dhënë para ekspertëve Institutit të Psikiatrisë Forenzike të marrë në mënyrë të kundërligjshme, nuk e ka aprovuar kërkesën e mbrojtjes me arsyetim se ekspertiza është bërë në shqyrtimin e kaluar dhe nxjerrja e një ekspertize të re do ta prolongonte procesin gjyqësor dhe nuk do të zbardhte çështjen, gjithashtu ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për marrjen e provave për gjendjen shëndetësore nga Qendra Korrektuese e L... dhe Burgu i D... në të cilat D.K ka vuajtur dënimet dhe ka qenë në trajtim të vazhdueshëm psikiatrik madje në Qendrën Korrektuese në L... i akuzuari D... ka tentuar që të bëjë vetëvrasje me litar për shkak të gjendjes së rëndë mendore me arsyetimin se dokumentacioni mjekësor gjendet në shkresat e

lëndës e që nuk është e vërtetë sepse në shkresat e lëndës në këtë çështje penale këto shkresa nuk gjenden fare dhe të njëjtat janë në favor të akuzuarit dhe si rezultat i kësaj gjykata ka qenë e obliguar që të marrë dhe të nxjerrë provat që vërtetojnë gjendjen reale mendore të akuzuarit para kryerjes së veprës, gjatë kryerjes së veprës penale dhe pas kryerjes së veprës penale.

Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale duke pretenduar se në bazë të dëshmisë së dëshmitares V.O ka vërtetuar se D.K ka qenë duke bashkëjetuar me M.O pa i vërtetuar kundërthëniet e kësaj deklarate. Në deklaratën e datës 26.10.2022 të dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe lexuar me datë 24.05.2024 në rigjykim dëshmitarja V.O ka deklaruar "i ka thënë profesorit se ajo çdo ditë niset për të ardhur në shkollë dhe ata kishin menduar se po i vijon mësimet", gjithashtu thekson "e njëjta kishte filluar të vonohet dhe kur e kam pyetur se çka është kjo vonesë ka theksuar se ka pirë kafe me disa shoqe të saj", çka nënkupton se M... ka jetuar në shtëpi me prindërit e saj. Ndërkaq po në të njëjtën deklaratë dëshmitarja V.O ka deklaruar se D.K dhe M.O kanë bashkëjetuar e cila deklaratë është në kundërtënie me të lartcekurat si dhe ka deklaruar se M... me D... kanë qenë të fejuar. Po ashtu, Gjykata e Apelit ka paraqitur si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2, nënpar.2.7 të KPRK-së pasi që në aktgjykimin e anuluar gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar se a ka pasur bashkëjetesë në pajtim me nenin 113 par.26 të KPRK-së, si dhe nuk ka vërtetuar faktin se a kanë bashkëjetuar por vetëm e ka cituar dispozitën e nenit 173 par.1, pika 1.3 të cilin gabim gjykata e shkallës së parë e ka përsëritur edhe në rigjykim edhe pse e ka pasur të qartë se nuk bëhet fjalë për vrasjen e anëtarit të familjes për shkak se M... dhe D... nuk kanë qenë duke bashkëjetuar por vetëm kanë qenë të fejuar dhe e kanë planifikuar martesën për muajin shtator.

Sipas mbrojtjes, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale duke refuzuar nxjerrjen e ekspertizës nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike, nxjerrjen e ekspertizës mjeko ligjore për të vërtetuar mizorinë, nxjerrjen e ekspertizës mjekoligjore për të vërtetuar në mostrat e gjakut toksikologjinë e të ndjerës dhe të akuzuarit. Po ashtu, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga ana e Prokurorit të shtetit është bërë edhe me datat 24.08.2021 dhe 25.08.2021, përkundër faktit se mjekët kujdestar kanë kërkuar që t'i bëhet testi narkotik të akuzuarit për shkak të gjendjes depresive dhe të vërtetohet shkalla e toksikologjisë dhe depresionit e të akuzuarit dhe një gjë e tillë i është mohuar.

Për më tepër, mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk e ka nuk e ka shqyrtuar fare fjalën përfundimtare të mbrojtësit të paraqitur me shkrim dhe nuk dhënë arsye në këtë dispozitë për arsye të mos paraqitjes në arsyetim të aktgjykimit të përmbledhur të fjalës përfundimtare të mbrojtësit të dorëzuar me shkrim, e që paraqet shkelje esenciale që parashihet në nenin 384 par.2, nënpar.2.2 të KPRK-së.

Sipas mbrojtjes, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal nga neni 385 par. 1, nën pikën 1.2 për shkak se nuk ka shqyrtuar elementin subjektiv të veprës penale të dashjes, me asnjë fjalë të vetme nuk është përshkruar dashja e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale. Mbrojtja konsideron se vepra penale është kryer nën ndikimin e substancave narkotike. Është fakt i pakontestueshëm se në bazë të shkresave të lëndës dhe në mënyrë të veçantë raportit të autopsisë se e ndjera M.O në ditën kritike ka qenë nën ndikimin e substancave narkotike. Gjithashtu në deklaratën e të akuzuarit A.S në shqyrtimin e parë gjyqësor dhe në deklaratën e të akuzuarit D.K si dhe raportet mjekësore nga dëshmia e doktorit A.H mbi gjendjen e të akuzuarit është vërtetuar se dy të akuzuarit dhe viktimja kanë qenë nën ndikim të substancave narkotike, çka do të thotë se janë plotësuar të gjitha elementet e veprës penale nga neni 19 të KPRK-së. Gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është paraqitur asnjë provë që dëshmon nëse i akuzuari para se të ketë sjellë vetën në një gjendje të tillë të dehjes nga substancat narkotike ka qenë i përfshirë me dashje apo nga pakujdesia në lidhje me veprën penale për të cilën është akuzuar, gjithashtu në aktakuzë nuk është paraqitur asnjë provë që vërteton elementin e dashjes sa i përket veprës penale nga neni 173 par. 1, nën par. 1.4 të KPRK-së. Në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktgjykimit dhe në arsyetim me asnjë fjalë të vetme nuk ka theksuar se ka ekzistuar dashja dhe nuk ka arsyetuar asnjë element të dashjes direkte apo eventuale për të kryer veprën penale të vrasjes. Gjukata nuk ka analizuar as forma tjera të përgjegjësisë qoftë pakujdesinë nga neni 23, qoftë lajthimin faktik etj.

Sipas mbrojtjes, shkelja e ligjit penal ekziston edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar dispozitën e nenit 173 par. 1, nën par. 1.3 dhe 1.4 të KPRK-së sepse D.K nuk e ka pasur anëtar të familjes M.O. Gjukata me asnjë provë të vetme materiale nuk e ka vërtetuar se i akuzuari ka bashkëjetuar me viktimën dhe pretendimin e saj e ka bazuar në dëshmitë kundërthënëse të prindërit të viktimës të cilat kanë qenë deklarata kundërthënëse dhe në fakt të dy prindërit e kanë pranuar se viktimja dhe i akuzuari D... kanë qenë të fejuar dhe se e kanë pasur të planifikuar që në shtator të njëjtit të martohen.

Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal nga neni 173 par. 1, nën par. 1.4 ku pretendon se është kryer vepra penale vrasja e rëndë duke privuar nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake pa u plotësuar elementet e veprës penale të kësaj vepre penale, pasi i akuzuari D... nuk ka ndërmarrë asnjë nga elementet e parapara me komentarin e kodit penal dhe nuk ka ndjerë asnjë lloj kënaqësie nga vuajtjet e të ndjerës dhe përkundrazi kur e ka vërejtur keqësimin e gjendjes shëndetësore të ndjerën e ka dërguar në spitalin e F... me qëllim që t'i ipet ndihma e parë.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja konsideron se gjykata e shkallës së parë për shkak të presionit të mediave të informimit nuk ka arrit të vërtetojë gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe si pasojë në mënyrë të gabuar. Aktgjykimin e saj e ka bazuar në dëshmitë e palëve të dëmtuara që natyrshëm dihet se janë subjektive pasi që janë familjarë me gjendje të rënduar shpirtërore nga humbja e anëtarit të familjes, në dëshmitë e dëshmitarëve jo okular që nuk asgjë për vendin e ngjarjes dhe në shkelje esenciale të nenit 119 par. 5 në mbrojtjen e dhënë para trupit të bashkë të pandehurit A.S. Gjukata e shkallës së parë në aktgjykim tha theksuar se ia ka falur besimin e plotë dëshmisë së dëshmitares V.O të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 26.10.2024 dhe lexuar në rigjykim me datë 24.05.2024. dëshmitarja ka deklaruar se e ndjera M... me datë 05.06.2021 ka pasur për ta dëgjuar suksesin ditën e shtunë dhe se nga shtëpia është nisur për të shkuar në ETC për të kërkuar punë dhe pastaj për ta dëgjuar suksesin, me çka vërtetohet se e ndjera ka qenë duke jetuar në shtëpi me prindërit e saj. Në të njëjtën dëshmi e njëjta ka deklaruar se M... ka bashkëjetuar me D... si dhe sa herë ka shkuar në banesën e D... i ka vërejtur shenja në fytyrë por në asnjë rast nuk është lajmëruar policia. Në të gjitha dëshmitë e saj dëshmitarja nuk ka përmendur në asnjë moment një datë apo ditë me të cilën e ndjera M... është larguar nga shtëpia e tyre për të shkuar dhe për të bashkëjetuar me D... Gjukata e shkallës së parë nuk ka mundur t'ia fal besimin e plotë për shkak të gjendjes emocionale të saj që ka qenë subjektive, gjithashtu se e njëjta nuk ka pasur asnjë informacion lidhur me ditën kritike kur ka ndodhur rasti. Gjithashtu edhe dëshmia e dëshmitarit M.O1 e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.10.2022, e lexuar në rigjykim me datë 24.05.2024 është kundërtënëse, pasi që i njëjti e përdor shprehjen që e ndjera M... ka ikur e që bëhet fjalë për vizitën e të ndjerës me D... në Sh... të Shq.. dhe pas kthimit nga Shq.. ka vërejtur shqetësime të njëjta, e gjithashtu e ndjera i ka treguar se në muajin shtator do të martohen me D... "përnjëme kur të vjen vëllai i D... nga Z..". Sikur do të ishin vlerësuar drejtë këto dëshmi do të vërtetohej

saktë se e ndjera M... dhe D... nuk kanë qenë duke bashkëjetuar, kanë qenë të fejuar dhe kanë planifikuar në muajin shtator të martohen pasi që në Kosovë ka planifikuar të vie vëllai i D..., K... i cili ka pasur të organizojë dasmën e të ndjerës me të akuzuarin D...

Sipas mbrojtjes, prova e nxjerrë përmes raportit të autopsisë nga ana e Institutit të Mjekësisë Ligjore ka konstatuar se mënyra apo karakteri i vdekjes është Vrasje mirëpo nuk ka treguar se për çfarë vrasje bëhet fjalë, si dhe nuk ka sqaruar në mënyrë shkencore se në veprimet e D.K a ka pasur elemente të mizorisë, gjithashtu nuk ka sqaruar në detaje se analiza toksikologjike e gjetur në gjakun e të ndjerës në cilën shkallë ka qenë, sa ka ndikuar në vdekjen e saj por vetëm duke përdorur metodën e LiasTest është detektuar THC dhe me metodën GC-MS është detektuar substanca narkotike tramadol pa e specifikuar sasinë dhe efektin që ka pasur tek e ndjera. Raporti i autopsisë i përgatitur nga eksperti mjekoligjor është në kundërshtim me nenin 133 par. 1, nën par. 1.3 sepse eksperti është i obliguar që ti sigurojë provat në mënyrë të ligjshme, në rastin konkret eksperti mjeko ligjor nuk ka analizuar provën e siguruar me analiza toksikologjike të kryer në IML në gjakun e të ndjerës, e cila analizë ka konstatuar se tek e ndjera është detektuar tramadol dhe THC, ndërkaq gjatë deklaramit të tij në rigjykim ka theksuar se në IML nuk mund të bëhet ekspertiza lidhur me shkallën toksikologjike për shkak të mungesës së pajisjeve dhe ekspertit të asaj fushe, mirëpo në kuadër të IMI, është sektori i toksikologjisë, është i punësuar eksperti i toksikologjisë, gjithashtu sipas informacioneve të siguruara në IML gjenden këto pajisje për të konstatuar shkallën e toksikologjisë në gjak dhe ndikimin e substancave të këtyre narkotikëve në ngulfatjen apo asfiksionin e viktimës dhe ndikimi i këtyre substancave në vdekjen e viktimës.

Sipas mbrojtjes, gjendja faktike nuk mund të vërtetohet drejtë duke paragjykuar faktin se është përdorur një kabëll e adapterit si mjet për të vlarë të ndjerën dhe gjithashtu kinse është përdorur shkopi i zi siç thuhet në aktgjykim dhe në anën tjetër të mos konfiskohen këto sende dhe të mos dërgohen për analizën e ADN-së sepse nëse e ndjera është goditur me to pa asnjë dyshim do të ishte vërtetuar me metoda shkencore përmes analizës së ADN-së.

Gjithashtu, mbrojtja dy herë gjatë rigjykimit ka kërkuar nga trupi gjykues që të marrë vendim me të cilën do të urdhëronte Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës që të nxjerrë ekspertizë të re psikiatrike duke u caktuar ekspertëve detyrat e qarta duke kërkuar nga ta që të konstatohet

se ditën kritike i akuzuari a ka përdorur substanca narkotike, nëse po cilat lloje të tyre, a kanë mundur të ndikojnë këto substanca narkotike në dehjen e të akuzuarit, në vetëdijen e tij për t'i kuptuar veprimet dhe sjelljet e tij ditën kritike duke përfshirë se a ka ekzistuar elementi volutiv i dashjes apo edhe elementi tjetër i përgjegjësisë penale, i pakujdesisë së tij në lidhje me veprën penale. Gjithashtu në propozim ka qenë i përfshirë që të bëhet edhe intervistimi i ligjshëm i të akuzuarit D... nga ana e ekspertëve nga IPFK dhe të njëjtit të obligohen që përmes metodave shkencore të hartojnë një ekspertizë që të përfshijnë të gjitha elementet e personalitetit të të akuzuarit para kryerjes së veprës penale, ditën e kryerjes së veprës penale dhe pas kryerjes së veprës penale dhe të konstatojnë se cili ka qenë ndikimi i përdorimit të substancave psikoaktive që është konstatuar në ekspertizën e parë. Gjithashtu ka refuzuar propozimet e mbrojtjes duke përfshirë sigurimin e dosjeve mjekësore nga Burgu i D... dhe ai i L.... Me këtë refuzim nga ana e KTG-së, gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 369 par. 7 dhe 8 të KPPK-së sepse nuk ka arritur që të arsyetojë faktin se për çka i ka konsideruar gjykata të parëndësishme dosjet mjekësore të Burgut të D... dhe të L... me të cilat vërtetohet se D.K ka qenë në Burgun e D... për trajtim për shkak të sëmundjeve mendore dhe gjithashtu vërtetohet që si rezultat i sëmundjeve mendore ka tentuar të bëjë vetëvrasje në Burgun e L... dhe në ato dokumentacione është udhëzuar trajtimi i detyrueshëm psikiatrik i detyrueshëm për shkak se është konstatuar se i akuzuari vuan nga sëmundjet psikike dhe mendore dhe këto dokumentacione nuk i kanë poseduar ekspertët e Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës sepse sikur t'i kishin këto dokumentacione me këto njohuri do të kishim një ekspertizë të bazuar në dokumentacion valid mjekësor dhe do të kishim konstatime të sakta shkencore lidhur me gjendjen e shëndetit mendor dhe psikik të D.K para kryerjes së veprës penale, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale dhe ndikimi i kësaj gjendje mendore në ditën kritike.

Lidhur me vendimin mbi sanksionin penal mbrojtja konsideron se neni 41 par.1 dhe 2 i KPRKsë në mënyrë të prerë e ndalon që të shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm si i vetmi dënim kryesor për një vepër të veçantë penale. Nuk mund të arsyetohet shqiptimi i dënimit të përjetshëm duke u bazuar në nenin 173 i cili parasheh dënim prej 10 deri në dënim të përjetshëm sepse zakonisht veprat penale të vrasjes kryhen me mjete të ndaluara me ligj apo mjete të paautorizuara siç janë armët. Në rastin konkret në aktakuzë por as në aktgjykim nuk përmendet në asnjë vend se D... ka kryer veprën penale me përdorimin e armës e cila do t'i kishte dhënë të drejtë gjykatës

t'i shqiptojë dy dënime kryesore dhe pastaj t'i shqiptojë dënimin unik qoftë edhe dënimi i përjetshëm.

Pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit A.S, Av. A.Sh

Mbrojtja në ankesë pretendon se me rastin e përpilimit të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 të KPPRK-së. Gjatë përpilimit të aktgjykimit dhe vlerësimit të provave të prezantuara në shqyrtim gjyqësorë nga faqe 24 deri faqe 26, përjashto CD me video incizimet nga banesa e të pandehurit D..., gjykata nuk vlerëson në favor apo nuk i cek fare se asnjë nga këto prova nuk e inkriminon të akuzuarin A.S. Dëshmitë e dëshmitarëve V.O, M.O1, E.P, B.M, B.M1 dhe A.H, si dhe ekspertit mjeko-ligjor N.H, gjykata e shkallës së parë ua falë besimin, mirëpo gjykata nuk ka dhënë fare arsyetimin se nga këto deklaratatë vërtetohet se i akuzuari A.S nuk i ka ndërmarrë veprimet me të cilat plotësohen elementet e veprës penale për të cilën edhe është dënuar. Me rastin e vlerësimit të mbrojtjes së A.S, gjykata e shkallës së parë vlerëson se e njëjta nuk është e besueshme për faktin se nga provat e prezantuara e në veçanti nga shiqimi i CD-së, por ky arsyetim bie në kundërshtim me vetvete me rastin kur gjykata konstaton se edhe nga raportet e ekspertizave të gjurmëve latente dhe ekspertizës së AND-së vërtetohet në mënyrë të pa dyshimtë se i akuzuari nuk ka ndërmarrë veprime të dhunshme ndaj të ndjerës, por i ka ndihmuar të akuzuarit D... duke i krijuar kushte. Pra, në njërin anë gjykata konfirmon mos përfshirjen e të akuzuarit A... bazuar në prova materiale, në anën tjetër thotë se nuk i falë besimin deklaratës së A.St dhe nuk jep arsyetim se mbi cilat prova bie në kundërshtim deklarimi i tij.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja konsideron se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike sepse edhe nga shqyrtimi i provave edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve nuk është vërtetuar se i akuzuari A.S ka dhënë ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë dhe gjykata fare nuk e ka arsyetuar se mbi cilat prova ka ardhë në përfundim se në veprimet e A... manifestohen elementet e ndihmës. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë sa i përket të akuzuarit A.S nuk përputhet me asnjërin nga elementet të cilat janë paraparë në nenin 33 të KPPRK-së, sepse shiqimi në derë nuk gjen mbështetje tek dhënia e këshillave apo udhëzimeve, as tek vënia në dispozicion të

mjeteve, as tek krijimi i kushteve ose mënjanimi i pengesave, as tek premtimi se do të fshehë provat, kryesin apo diçka të ngjashme. Për të ngarkuar të akuzuarin A... se i njëjti ka dhënë ndihmë duke shiqur nga vrima e derës se mos ndokush nga banorët është duke dëgjuar apo kaluar andej do të duhej të paraqiteshin rrethana të tilla si: A është paraqitur ndonjë dëshmitar i cili vërteton faktin se janë dëgjuar zhurma nga banesa e të akuzuarit D... dhe pas kësaj i akuzuari A... i ka larguar apo manipuluar këto zhurma? Në cilën provë është mbështetur gjykata kur ka konstatuar çështjen e zhurmës, Sepse me asnjë provë të vetme nuk është përmend një fakt i tillë? Në të kundërtën nga dëgjimi i ekspertit mjekoligjor thotë se tek viktimja janë gjetur përmbajtje të elementit Tramadol i cili ka efekt qetësimi. Pra në këtë rast gjykata një fakt të tillë e nxjerrë në bazë të supozimeve dhe jo provave materiale për të cilat edhe obligohet që çdo fakt të çështjes ta bazoj në prova materiale.

Sipas mbrojtjes, nëse i pandehuri A... ka qenë nën ndikimin e narkotikëve veprimet e tij nuk kanë qenë të planifikuara apo menduara mirë për të shprehur dashjen sepse me përdorimin e Marihuanës-Kanabisit ka efekte psikoaktive dhe fiziologjike kur konsumohet. Përveç ndryshimit subjektiv në përceptim dhe humor, efektet tjera më të shpeshta afat shkurta fizike dhe neurologjike përfshijnë rrahje më të shpeshta të zemrës, presion të ulët të gjaku, dobësim të memories afat shkurtër, koordinimit të lëvizjeve dhe koncentrimin. Ndërsa sa i përket elementit që A...i ka pas qëllim t'i ofrojë ndihmën të akuzuarit D... edhe kjo gjë nuk gjen mbështetje vetëm për faktin pse i akuzuari A... ka qëndruar tek banesa e të akuzuarit D... në natën kritike, sepse arsyeja pse ka qëndruar aty i pandehuri A... ka dhënë arsyetimin e tij dhe gjykata do të duhej ta merrte të besueshme.

Për më tepër sipas mbrojtjes, janë edhe dy fakte tjera të cilat mbështeten në provat materiale që vërtetojnë se A.S nuk ka pas për qëllim t'i ofrojë asnjë lloj ndihme apo të jetë i përfshirë në vrasjen e të ndjerës M..., e para ka të bëjë me faktin se sikurse të ishte qëllim vrasja apo ndihma në vrasje, i pandehuri A.S nuk do të kërkonte nga i akuzuari D... që të ndjerën ta dërgojnë në

Spitalin e F... në emergjencë në mënyrë që t'i jepet ndihma mjekësore dhe këtë menjëherë pasi ta kuptoj se çfarë ka ndodhur me tani të ndjerën. Sikurse tek A.S të ekzistonte dashja dhe qëllimi në kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, gjykata e shkallës së parë nuk mori në konsideratë edhe faktin se A.S me profesion është IT-njohës i teknologjisë, ka qenë në dijeni

për kamerat e sigurisë të vendosur në korridorin e banesës së D.K si dhe pasi e dërgojnë M.O në spital i njëjti kthehet në banesën e të akuzuarit D..., por nuk fshehë, nuk largon apo manipulon provat videoincizimet për të cilat tani gjykata i ngarkon në dëm të të pandehurit A.S dhe nuk qëndron arsyetimi i gjykatës se i njëjti nuk ka qenë në gjendje për t'i kuptuar pasojat dhe nuk i ka premtuar koha, sepse pas kësaj i njëjti është paraqitur në Stacionin e Policisë në F....

Për më tepër sipas mbrojtjes, gjykata e shkallës së parë nuk ka ftuar dëshmitarët e rinj, as nuk ka dhënë arsye- sqarime shtesë se mbi cilat baza ka vërtetuar kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari A.S ashtu siç kërkohet edhe nga Gjykata e Apelit, për më tepër ky aktgjykim fare nuk dallon nga ai i shqyrtimit të kaluar.

Gjithashtu sipas mbrojtjes gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.1.1 ngase të akuzuarin A.S e ka shpallur fajtor për veprën penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, nënpar.1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së ndërsa në arsyetimin e saj në veprimet të cilat pretendon gjykata se i ka ndërmarr A.S nuk përmbushën elementet e veprës penale për të cilin është dënuar.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të Prokurorit të shtetit dhe të mbrojtësve të të akuzuarve sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë, e gjithashtu nuk ka shkelje tjera të dispozitave të procedurës nga neni 384 të KPPRK-së, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e këtij aktgjykimi.

Dispozitivi i aktgjyqimit është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni të plotë me arsyetimin, ndërsa në arsyetim janë dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit D.K janë formësuar elementet e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së, dhe në veprimet e të akuzuarit A.S janë formësuar elementet e veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 pika 1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së. Ndërsa me provat e administurara nuk është vërtetuar se i akuzuari D.K të ketë kryer veprën penale Dhunimi nga neni 227 par.4,

nënp.4.1 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe i akuzuari A.S të ketë kryer veprën penale Ndhmë në kryerjen e Dhunimit nga neni 227 par.4, nënp.4.1 lidhur me par.1 dhe nenin 33 të KPRK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka analizuar të gjitha provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto prova ka paraqitur konkludimet e saj, e të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i vlerëson edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me nenin 360 të KPPRK-së, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprave penale nga ana e të akuzuarve.

Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i mbrojtësit të të akuzuarit D.K, Av. S.M se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 406 par.3 të KPPRK-së, pasi që Gjykata e Apelit shprehimisht ka kërkuar që në rigjykim çështja e mizorisë të vërtetohet nga ekspertët e mjekësisë ligjore përmes ekspertizës, ngase Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit dhe me qëllim të vërtetimit të mizorisë, në shqyrtimin gjyqësor të datës 11.06.2024, ka dëgjuar ekspertin e mjekësisë ligjore Dr. N.H, i cili ka deklaruar se vdekja e të ndjerës ka ardhë si pasojë e lëndimeve të shumëfishta që ndryshe quhet si politraumë, dhe kur ka të bëjë me politraumë ka të bëjë me disa forma si: asfiksia, shtypja dhe përplasja, të cilat lëndime kanë ardhë si pasojë e dëmtimit të organeve vitale trupore, e që të gjitha këto lëndime kanë qenë të shkaktuara nga mjetet mbretëse pa teh dhe maje dhe eksperti ka konfirmuar se të gjitha këto lëndime të ndjerës iu janë shkaktuar për së gjalli. Sa i përket mekanizmit të dhembjeve eksperti mjeko ligjor dhembjet i ka ndarë në 3 (tri) grupe: në dhembje posaçërisht të rënda, dhembje të rënda dhe dhembje të lehta dhe në bazë të lëndimeve të cilat i ka pësuar e ndjera, e të cilat janë përshkruar në raportin e autopsisë, eksperti mjeko-ligjor ka konstatuar se e ndjera ka përjetuar dhimbje posaçërisht të rënda dhe të rënda. Andaj edhe kolegji i kësaj gjykate pajtohet në tërësi me konstatimin e Gjykatës së shkallës së parë sa i përket ekzistimit të mizorisë, ngase sipas konfirmimit të ekspertit të mjekësisë ligjore viktima ka përjetuar dhimbje posaçërisht të rënda dhe dhimbje të rënda, e që në këtë rast mizoria është e pakontestueshme.

Gjithashtu, kolegji vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i mbrojtësit të të akuzuarit D.K se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave kur ka refuzuar propozimin e

mbrojtësit për nxjerrjen e ekspertizës nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike. Gjykata e shkallës së parë drejt ka refuzuar propozimin e mbrojtjes ngase i akuzuari D.K ka qëndruar në Institut nga data 01.03.2023 deri me datë 23.03.2023 dhe gjatë asaj kohe të njëjtit nga grupi i ekspertëve i është bërë ekzaminimi dhe në ekspertizën e datës 25.04.2023, kanë përshkruar gjendjen e shëndetit mendor të tij. Nga përmbajtja e raportit të përpiluar me shkrim te ekipit te ekspertëve te këtij Instituti rezulton se nga i akuzuari është marr edhe historiat dhe në këtë raport ne tërësi janë shënuar te gjitha ngjarjet që i kane ndodhur te akuzuarit para kryerjes se veprës penale, gjithashtu është shikuar edhe dokumentacioni psikik, konkretisht raportet psikiatrike qe i ka ofruar i akuzuari, ekzaminimet diagnostikuese, te dhënat e përgjithshme anamnestike, këto te dhënat e siguruara nga nëna e tij dhe ne fund është përshkruar edhe mendimi dhe konstatimi i ekipit te eksperteve, ku ne piken 4 te këtij konstatimi është shënuar se ne momentin e kryerjes se veprës për te cilën akuzohet aftësia e tij mendore qe te kuptoj rëndësinë e veprës dhe aftësia e kontrollit te veprimeve të tij kanë qenë të ruajtura ku kjo është e bazuar edhe në sjelljen e tij dhe dinamiken e ngjarjes, para, gjatë dhe pas veprës, ndërsa ne piken 5 te këtij raporti është shënuar se mund te marr pjese në seanca gjyqësore, është i afte ta mbroj veten, qe te konsultohet me persona te tjerë duke përfshire edhe mbrojtësin, si dhe ka aftësi për ta kuptuar akuzën dhe për tu përballur me gjykimin. Andaj edhe kolegji i kësaj gjykate pajtohet me konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se dërgimi i serishëm i të akuzuarit për ekzaminim ne këtë institut është i pa nevojshëm.

Po ashtu, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se nuk qëndron pretendimi i mbrojtësit të të akuzuarit D.K, se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se fjala përfundimtare e mbrojtësit e dorëzuar me shkrim nuk është përfshirë dhe nuk është përmbledh në aktgjykim, ngase gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka vlerësuar pretendimet e mbrojtjes të paraqitura më shkrim në fjalën e tij përfundimtare.

Sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtësve të të akuzuarve përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se Gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari D.K ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nenpar.1.4, te KPRK-së,

ndërsa i akuzuari A.S ka kryer veprën penale Ndhurma në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, për të cilat janë shpallur fajtor. Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari D.K në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, nga fakti se me datë 21 gusht 2021 në banesën e tij, ne rrugën “R....” ne F..., në intervalin kohor nga ora 10:14 deri të nesërmen me datë 22 gusht 2021 në ora 14:43, në mënyrë mizore e privon nga jeta të ndjerën M.O, me të cilën ka qenë duke bashkëjetuar, në atë mënyrë që gjatë dy ditëve rresht, në vazhdimësi, kohë pas kohe, me vetëdije ndërmerr veprime të dhunshme posaçërisht të rënda – ekstreme ndaj saj, duke e goditur me një shkop të drurit, ngjyrë të zezë në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar mundime dhe dhimbje të mëdha fizike dhe psiqike, ku nga pasojat e kësaj dhune ekstreme të shkaktuara nga goditjet, shtypja apo përplasja nga ndonjë mjet të fortë dhe të rëndë mbretës shkaktohet vdekja e të ndjerës M.O, e cila ka ardhur si rrjedhojë e politraumes – lëndimeve të shumëfishta, ku politrauma dhe vdekja kanë ardhur drejtpërsëdrejti nga asfiksia mekanike, si dhe shoku hemorragjik dhe traumatik, të cilat janë pasojë e gjakderdhjes së jashtme dhe gjakderdhjes së brendshme, nga thyerjet e ashtit të nofullës së poshtme, thyerjet e brinjëve djathtas dhe majtas, klavikulës së majtë, unazave të qafës, gjakderdhjes epidurale dhe subdurale në pjesën e pasme të trurit të madh dhe në trurin e vogël, këputje parciale të palcës së kurrut në qafë, dhe të njëjtën me ndihmën e të pandehurit A.S e dërgojnë në Spitalin në F... dhe largohen nga aty.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari A.S në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor ngase me datë, vend dhe kohë të përshkruar si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, me dashje i ka ndihmuar të akuzuarit D.K ta kryej veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-se, në atë mënyrë që fillimisht kontakton përmes telefonit, dhe takohen në qytet, pastaj së bashku kthehen në banesën e të akuzuarit D.K, i cili ishte duke bashkëjetuar me tani të ndjerën M.O, dhe me dashje ndërmerre veprime duke i krijuar të akuzuarit D.K kushte për kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që përderisa i akuzuari D... ishte duke ushtruar dhunë fizike posaçërisht të rëndë ndaj të ndjerës M..., i akuzuari A... hynë në dhomën ku ishte e ndjera, ku aty i njëjti hynë dhe delë disa herë dhe gjatë gjithë kohës bisedojnë me D..., pastaj shkon tek dera e hyrjes së banesës dhe provon se a është dera e mbyllur me qelës si dhe përmes vrimës së derës së hyrjes shikon dhe përcjell gjendjen nëse ndonjë nga banorët

është duke dëgjuar apo lëvizur aty pari, e të cilat veprime i njëjti gjatë qëndrimit në banesë i përsëritë në mënyrë të vazhdueshme herë pas here për të i mënjanuar pengesat për gjatë kohës sa i akuzuari D... ishte duke ushtruar dhunë fizike ekstreme tek e ndjera M..., po ashtu i njëjti disa herë del nga banesa për të blerë gjëra ushqimore për të akuzuarin D... dhe për vete, ku edhe nga video incizimi vërehet se gjatë gjithë kohës së qëndrimit në banesë i akuzuari A... dhe i akuzuari D... kanë biseduar me telefona dhe njëkohësisht kanë biseduar në mes vete, ku dhe qëndrimi i tij gjatë gjithë natës duke bërë roje në banesën e të akuzuarit D... tregon qëllimin e tij për të i ndihmuar të akuzuarit D.K në kryerjen e veprës penale.

Deri të kjo gjendje faktike, Gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit të provave personale siç janë: dëshmia e të dëmtuares-dëshmitares V.O, dëshmia e të dëmtuarit- dëshmitarit M.O1, dëshmitë e dëshmitarëve E.P, B.M, B.M, A.H, si dëshmia e ekspertit mjekoligjor N.H. Ndërsa ka administruar këto prova materiale: Përmbajtja e raportit të Autopsisë nga IML me numër të referencës MA21-248, i datës 23.08.2021, Fotoalbumi i bërë gjatë Autopsisë me numër të dosjes së forenzikës VN#51/08/2021, i datës 23.08.2021, Njoftimi nga Drejtoria e Teknikës Kriminalistike – Sektori për Fotografi, Video analizë dhe Ekzaminime të TI-së, me numër të dosjes 164-FVTI-2021, i datës 26.10.2021, Raporti i ekspertizës nga DTK – Sektori për Fotografi, Video analizë dhe Ekzaminime të TI-së – Njësia për Ekzaminimin e Pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit, me numër të dosjes së forenzikës VN#51-08/21, i datës 11.10.2021, Raporti i ekspertimit nga AKF me numër të referencës AKF/2021-2466/2021-2357, i datës 22.02.2022, Raporti i ekspertizës nga ABIS – Njësia për ekspertimin e gjurmëve latente dhe shenjave standarde, me numër të referencës AFF#27-2021, i datës 06.09.2021, Dosja e forenzikës me numër të referencës VN#51-08/21, e datës 22.08.2021, Raporti informues i hetuesit me numër 2022-CF-1791, i datës 22.08.2021, Libri për evidencën e thirrjeve në Kompaninë e Sigurimeve “S...”, për datën 21.08.2022, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht me numër 2021-CF-1791, i datës 24.08.2021, Vërtetim mbi konfiskimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht me numër 2021-CF-1971, i datës 23.08.2021, Procesverbal për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm, i datës 22.08.2021, Raporti i oficerit me numër 2021-CF-1971, i datës 22.08.2021, Foto albumi në Emergjencën e SP F..., me numër të dosjes së Forenzikës VN#51/08/2021, i datës 22.08.2021, Foto albumi në banesën e të pandehurit D.K, me numër të dosjes së Forenzikës VN#51/08/2021, i datës 22.08.2021, CD me video incizimet nga lokali “CT B...”, 2 CD me video incizimet nga banesa e të pandehurit

D.K, Raporti për gjendjen e shëndetit mendor të të akuzuarit D.K, i përpiluar nga ekipi i ekspertëve nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës i dt. 25.04.2023. Trupi gjykues në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 24.05.2024, pas propozimit të prokurorit të shtetit dhe pëlqimit të palëve, përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe mbrojtësve të të akuzuarve, konform nenit 307 par. 1 dhe 3 të KPPRK-së pasi që të gjitha palët janë pajtuar ka marrë aktvendim që të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor dhe atë: Dëshmia e të dëmtuarës – dëshmitares V.O dhe dëshmia e të dëmtuarit dëshmitarit M.O1 të dhëna në shqyrtimin e kaluar gjyqësor me datë 26.10.2022, dëshmia e dëshmitarit E.P, e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datën 09.11.2022, dëshmia e dëshmitarit B.M, e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datën 10.11.2022, dëshmia e dëshmitarit- ekspertit N.H- Ekspert Mjekoligjor, e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 10.11.2022, dëshmia e dëshmitarit B.M, e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datën 29.12.2022, dëshmia e dëshmitarit A.H, e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datën 24.01.2023.

Andaj pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit D.K, se nga Gjykata e shkallës së parë gjendja faktike në këtë çështje nuk është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë janë pretendime të pabazuara, pasi që nga provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari D... me dashje, në mënyrë mizore duke e goditur me një kablo të mbushjes së telefonit dhe me një shkop të zi e ka privuar nga jeta të ndjerën M.O, me të cilën ka qenë duke bashkëjetuar, ku vdekja e saj ka qenë e ngadalshme, si pasojë e përdorimit të forcës fizike në mënyrë graduale, kohë pas kohe për një periudhë kohore prej së paku prej 48 orëve, duke i shkaktuar dhembje të mëdha fizike dhe psikike. Se i akuzuari D.K ka ushtruar dhunë posaçërisht të rëndë-ekstreme të rëndë ndaj të ndjerës M.O, është vërtetuar edhe nga raporti i autopsisë nr.ref.MA21-248, të datës 23.08.2021, i përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Prof. Dr.N.H, në të cilin raport janë të përshkruara në detaje të gjitha lëndimet e shkaktuara të shumëfishta trupore dhe shkaku i vdekjes së saj. Ndërsa faktin se i akuzuari D.K dhe e ndjera M.O kanë qenë në bashkësi jashtë martesore, gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar nga deklaratimet e prindërve të të ndjerës, M.O1 dhe V.O të cilët janë dëgjuar në cilësi të dëmtuarve-dëshmitareve në shqyrtimin gjyqësor të datës 26.10.2022 dhe të njëjtat dëshmi janë lexuar edhe në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.05.2024, të cilët kanë deklaruar se me datën 5 qershor 2021, që ka qenë ditë e shtunë kur e ndjera M... ka filluar të bashkëjetoj me të akuzuarin D.K. Andaj gjykata e shkallës së parë drejt ka vlerësuar se plotësohet elementi i veprës penale vrasje e rëndë

nga neni 173 par.1, nën par.1.3 të KPRK-së, meqë i akuzuari e ka privuar nga jeta anëtarin e familjes.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të mbrojtëses së të akuzuarit A.S, Av. A.Sh se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse nga shqyrtimi i provave dhe dëgjimi i dëshmitarëve nuk është vërtetuar se i akuzuari A... ka dhënë ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë janë pretendime të pabazuara, ngase gjykata e shkallës së parë drejt ka vlerësuar se i akuzuari Abër Sejdiu me vetëdije i ka ndihmuar të akuzuarit D.K në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së, duke ia krijuar kushtet për kryerjen e kësaj vepre penale, në atë mënyrë që për të mënjanuar pengesat përgjatë kohës sa i akuzuari D... ishte duke ushtruar dhunë fizike ekstreme të rëndë ndaj të ndjerës, i akuzuari A.S në vazhdimësi e përcjell gjendjen në vendin ku ishte duke u ushtruar dhuna, në banesën e të akuzuarit D..., ashtu që kohë pas kohe hynë në dhomën e fjetjes ku ishte e ndjera ndaj së cilës ushtrohej dhuna, ku aty i njëjti hynë dhe del disa herë dhe gjatë gjithë kohës e këshillon dhe bisedojnë me D...n, pastaj shkon te dera e hyrjes së banesës dhe përmes vrimës së derës së hyrjes shikon dhe përcjellë-monitoron gjendjen nëse ndonjë nga banorët apo ndokush tjetër është duke dëgjuar apo lëvizur aty pari, e provon derën e hyrjes se a është e mbyllur me qelës, del disa herë nga banesa për të blerë gjëra ushqimore për të akuzuarin D... dhe për vete, ku këto veprime i akuzuari i ka përsëritur në vazhdimësi dhe në vazhdimësi ka qëndruar në banesën e të akuzuarit D... duke bërë aty roje gjersa i akuzuari D... ka qenë duke ushtruar dhunë posaçërisht të rëndë fizike dhe psikike ndaj të ndjerës M.O.

Gjithashtu, sa i përket pretendimeve të mbrojtjes se të akuzuarit A.S, se i njëjti nuk ka pasur për qëllim t'i ofrojë asnjë lloj ndihme apo të jetë i përfshirë në vrasjen e të ndjerës M..., sepse sikur të ishte qëllimi vrasja apo ndihma në vrasje, nuk do të kërkonte nga i akuzuari D... që të ndjerën ta dërgojnë në spitalin e F... në mënyrë që t'i jepet ndihmë mjekësore, e poashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka marr në konsideratë faktin se A.S me profesion është IT dhe ka qenë në dijeni për kamerat e sigurisë të vendosura në korridorin e banesës së D.K, por nuk ka fsheh, nuk ka larguar apo manipuluar provat- videoincizimet, Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime të mbrojtjes i vlerëson si të pabazuara, ngase gjykata e shkallës së parë drejt ka vlerësuar se të akuzuarit të ndjerën M.O e kanë dërguar në spital pasi e kanë kuptuar se e njëjta ka vdekur nga dhuna e ushtruar, dhe nuk e kanë dërguar në spital për t'i dhënë ndihmë mjekësore por për ta

larguar nga banesa, andaj sikur të ekzistonte qëllimi i të akuzuarit A... për të ndihmuar të ndjerën ai do të kërkonte më herët për ta dërguar në emergjencë për t'i dhënë ndihmën mjekësore para se të ndodhte vdekja e saj. Por përkundrazi, gjersa i akuzuari D... ka ushtruar dhunë të pa parë fizike dhe psiqike ndaj të ndjerës, i akuzuari A... ka bërë roje në banesën e tij duke e përcjellë dhe monitoruar gjendjen nëse po i vëren ndokush se çka është duke ndodhur aty, duke lëvizur herë te dera e dhomës ku i akuzuari D... ushtronte dhunë ndaj të ndjerës, e herë te dera e hyrjes duke provuar se a është dera e mbyllur me qelës dhe duke shiquar pa ndërprerë në vrimën e derës së hyrjes se mos po i vëren dhe po dëgjon britmën ndokush nga jashtë. Gjithashtu edhe pretendimi tjetër i mbrojtjes se i akuzuari A... pasi është kthyer nga spitali në banesë ka mundur t'i fshijë provat, përkatësisht të largojë kamerën e videoinçizimit, kolegji pajtohet me konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se ai kamerën nuk e ka hjekur për shkak se ai në ato momente nuk ka qenë në gjendje për t'i pasojat e ekzistimit të kamerës dhe sigurisht edhe nuk i ka premtuar koha, se për shkak të pasojave të shkaktuara, vdekjes së të ndjerës është munduar sa më parë të largohet nga ajo banesë.

Sa i përket pretendimeve ankimore të prokurorit të shtetit lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për pjesën liruese të aktgjykimit, Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë. Se nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se i akuzuari D.K në banesën e tij pa pëlqimin e saj e ka detyruar të ndjerën M.O për të kryer marrëdhënie seksuale..., gjykata e shkallës së parë drejt ka vlerësuar se me asnjë provë nuk është arritur të vërtetohet se është kryer vepra penale e dhunimit. Raporti i Autopsisë MA21-248, i datës 23.08.2021 sqaron shkakun e vdekjes dhe sqaron në detaje dëmtimet e të ndjerës M.O, por në asnjë mënyrë ky raport nuk ka përcaktuar se viktimja ka qenë e dhunuar seksualisht. Po ashtu, as nga deklaratat e dëshmitarëve dhe deklaratat e ekspertit të mjekësisë ligjore, e as nga video incizimit nga kamera e sigurisë e vendosur brenda banesës së të akuzuarit D.K, nuk është vërtetuar se ndaj viktimës është kryer vepra penale e dhunimit. Kamera e sigurisë e vendosur në korridorin e banesës ka regjistruar vetëm në drejtim të derës së hyrjes së banesës dhe në drejtim të banjës, andaj nga e njëjta nuk ka mundur të konstatohet se i akuzuari ka kryer aktin seksual në sallon me të ndjerën gjersa në sallon nuk është parë asgjë. Gjithashtu pretendimin e prokurorit se me kalimin e kohës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore si pasojë e dhunës së ushtruar humb aftësinë për të rezistuar, e ku në dy raste në mbrëmje kryen marrëdhënie seksuale pastaj të zhveshur e dërgon në banjo, e ku i vërehen edhe lëndimet në trup, kolegji e vlerëson si të pabazuar ngase gjykata e

shkallës së parë drejt ka vlerësuar se nga shikimi i CD-ve me video incizimet nga banesa e të akuzuarit, në asnjë moment nuk vërehet se i akuzuari me datë 21 gusht 2021 ka kryer marrëdhënie seksuale me të ndjerën.

Gjithashtu pretendimi i prokurorit se i akuzuari A.S e ka ndihmuar të akuzuarin D.K në kryerjen e veprës penale të dhunimit, sipas kolegjit të kësaj gjykate është i pabazuar, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se është kryer vepra e dhunimit dhe kur nuk ekziston vepra bazë e dhunimit, nuk mund të ekzistojë as ndihma në kryerjen e veprës penale të dhunimit.

Andaj, Gjykata e Apelit e Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

Kolegji penal i kësaj gjykate i vlerëson si të pabazuara pretendimet ankimore të mbrojtësve të të akuzuarve lidhur me shkeljen e ligjit penal, pasi nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e KPPRK-së të cilat konsiderohen shkelje e ligjit penal, në veprimet e të akuzuarve formësohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale për të cilat të njëjtit janë shpallur fajtor, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale apo ndjekjen penale të të akuzuarve.

Sa i përket pretendimeve ankimore të Prokurorit të shtetit, përfaqësuesit të palëve të dëmtuara dhe mbrojtësve të akuzuarve lidhur me vendimin mbi dënimin, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marr parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Gjykata e shkallës së parë për të akuzuarin D.K nuk ka gjetur rrethana lehtësuese, ndërsa rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e lartë të përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, intensitetin e lartë të dëmtimit të vlerës së mbrojtur - e drejta në jetë, e cila garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventat Ndërkombëtare të cilat janë të zbatueshme drejtpërdrejt në vendin tonë, se veprën penale i akuzuari e ka kryer me paramendim, ndaj anëtarit të ngushtë të familjes - tani te ndjerën M.O me të cilën ka qenë duke bashkëjetuar, moshën e re të të ndjerës, e cila veç sa e kishte arritur moshën 18 vjeçare, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, ne mënyrën me barbare me privimin gradual nga jeta ne një ambient te mbyllur ne banese, ku e ndjera ka qenë krejtësisht e pa mbrojtur, faktin se i akuzuari ka qenë edhe më pare i dënuar me aktgjykime të shumta të formës së prerë për

vepra penale të natyrave të ndryshme. Andaj, të gjitha këto veprime të të akuzuarit në unitetin e tyre tregojnë shkallën e lartë të pjesëmarrjes dhe shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, ku nga kjo vepër penale janë shkaktuar pasoja të rënda në familjen e të ndjerës dhe është shkaktuar shqetësim i madh edhe tek qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ndërsa për të akuzuarin A.S Gjykata e shkallës së parë mori parasysh sjelljen e tij gjatë procedurës penale, faktin se më parë i njëjti nuk është i dënuar me ndonjë vendim të formës së prerë, ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarin, gjykata morri parasysh shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e veprës penale meqë i akuzuari ka qëndruar gjatë gjithë kohës sa është ushtruar dhuna ndaj të ndjerës nga ana e të akuzuarit D... dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të evitimit të kësaj dhune, por përkundrazi me vetëdije i njëjti ia ka krijuar kushtet të akuzuarit D... përkatësisht i ka eliminuar pengesat në kryerjen e kësaj vepre penale, pasi qe vepra penale është kryer krejtësisht në një ambient të mbyllur brenda në banesë ndaj një viktime të moshës së re dhe shumë të ndjeshme e cila ishte krejtësisht e pa mbrojtur, dhe në vazhdimësi është kujdesur që dera e banesës të jetë e mbyllur që mos të dëgjojnë banoret tjerë të banesës apo ndonjë kalimtar i rastit, duke i pamundësuar edhe të tjerëve që të mos arrijnë në zbulimin e dhunës ekstreme të rëndë që ishte duke u ushtruar ndaj të ndjerës.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Ndërsa, pretendimin e prokurorit dhe përfaqësuesit të palëve të dëmtuara për një dënim më të lartë ndaj të akuzuarit A.S, kjo Gjykatë e vlerëson si të pabazuar pasi që të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese kanë qenë objekt vlerësimi nga Gjykata e shkallës së parë dhe pikërisht si rezultat i këtyre rrethanave të njëjtit i është shqiptuar dënimi përkatës, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të Kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Ndërsa pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit D.K, se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 41 par.1 dhe 2 sepse e ka pasur të ndaluar dhe të pamundshëm shqiptimin e dënimit të përjetshëm, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se ky pretendim nuk qëndron ngase dispozita e nenit 41 të KPRK-së nuk e përjashton mundësinë e shqiptimit të dënimit me burgim të përjetshëm për veprat më të rënda penale, por nuk parashihet si i vetmi dënim kryesor për një vepër penale, andaj në rastin konkret duke vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese të të

akuzuarit sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit me burgim të përjetshëm për të akuzuarin D.K.

Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të kryera dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të parandalohen të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PAKR.nr.691/2024

Datë: 14.01.2025

Bashkëpunëtorja Profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit

Jeta Asllani

Kadrije Goga Lubishtani

Xhevdet Abazi

Hashim Çollaku